

CV drejtuar një organizatë/institucioni/kapitull *acquis* që përbën

interes Modeli:

Sugjerohet të shtohet logoja e kompanisë si një kokë.

Të përdoret i njëjti format shkrimi gjatë gjithë dokumentit.

- **Detajet e kontaktit janë të rëndësishme:**

- 1) Emri i plotë i organizatës/shkurtesa;
- 2) Adresa;
- 3) personi i kontaktit (Emri, pozicioni, emaili)
- 4) faqja në internet (nëse ka);
- 5) email zyrtar;
- 6) telefoni;
- 7) lloji i organizatës (OJQ, Shoqatë, Biznes etj);
- 8) Llogaritë e mediave sociale (nëse ka)

- **Një informacion për organizatën/institucionin**

- Referenca në dokumentacionin e themelimit (ligj, akt nënligjor, statuti, etj.)
- Qëllimet kryesore dhe programet tematike
- Aktivitetet dhe fushat kryesore të punës
- Informacioni organizativ (stafi, rrjeti)

- **Fushat e ekspertizës**

- Në këtë pjesë duhet shpjeguar se si funksioni/puna e organizatës është e lidhur me një ose disa nga çështjet e kapitullit në fjalë.
- Sugjerohet të tregohen disa nga aktivitetet/projektet që lidhen me temat e kapitullit
- Sugjerohet të tregohet përvoja dhe ekspertiza e stafit të përfshirë (nëse është rasti)
- Nëse ka lidhje të rëndësishme të lidhura me funksionimin e organizatës, mund të tregohet një listë e publikimeve - me linket përkatëse

Shprehja e Interesit të organizatës/institucionit

- **Duhet të shprehë arsyet pse organizata po aplikon**
 - motivimi kryesor
 - si ndikohet apo përfshihet organizata në procesin e negociatave dhe zhvillimit të kapitullit
 - si lidhet puna e tyre me një ose disa nga çështjet e kapitullit
- **Çfarë presin ata nga kjo tryezë e diskutimit dhe të këshillimit**
 - pritshmëritë e tyre kryesore nga tryezat e konsultimit
 - çfarë duan të diskutojë/përfshijë kjo tryezë
- **Planifikimi i kontributit tuaj gjatë diskutimeve dhe procesit të negociatave të kapitujve**
 - të jenë sa më konkretë për të ofruar aktivitete/sugjerime sesi organizata do të kontribuojë gjatë tryezës së konsultimit
 - Angazhimi dhe përfshirja aktive në zhvillimet e tryezës
 - ofrimi i ekspertizës dhe sugjerimeve/rekomandimeve gjatë diskutimeve
 - ofrimi i temave për diskutim